



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 74

Prishtinë, më 20 korrik 2010, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylaj, Teuta Hadri, Flora Brovina, Vezira Emrush dhe Qamile Morina.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Zyrës së Komisioneve të Kuvendit, Enis Halimi – zyrtar i fushës, Liridon Selmani – KDI, Besart Mustafa- praktikant.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 30. 06. 2010 dhe 06. 07. 2010;
3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, Bujar Bukoshi;
4. Rishqyrtimi i planit të punës të Komisionit;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 30. 06. 2010 dhe 06. 07. 2010

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale i miratoi pa vërejtje procesverbalet e këtyre mbledhjeve.

3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, Bujar Bukoshi

Sadik Idriz – Mirë se erdhët! Ne, sipas planit tonë, ju kemi ftuar në këtë takim. Kemi dashur ta bëjmë ftesën më herët, por për shkak të ndryshimeve, që janë bërë në Ministri, kemi pritur t'i bëni 100 ditë në postin e ministrit që të mund të bisedojmë. Komisioni ka dashur të dijë për punën në Ministri. Këtë e kemi përmbledhur në tri çështje: punët e kryera në Ministri 3 - 4 muajt e fundit, përparësitë e Ministrisë, që i keni deri në fund të vitit dhe bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë dhe Komisionit.

Bujar Bukoshi - Faleminderit për këto fjalë të mira. Si ish-anëtar i këtij Komisioni, e ndiej veten mirë në mesin tuaj. Ministria, në çdo kohë, kur Komisioni e konsideron të nevojshme, duhet të vijë e të raportojë këtu. Qëkur e kam marrë detyrën, jam angazhuar të ketë vazhdimësi dhe të mos ketë hendeqe në vazhdimin e punës sonë. Jemi përpjekur ta ndërrojmë mënyrën e qeverisjes në këtë sektor, të cilin e udhëheqim. Ndonëse me shumë probleme në këtë sektor, e kemi filluar punën pa paragjykime. Konsideroj se aty duhet të bëhet punë e përbashkët dhe e koordinuar ndërmjet shumë institucioneve, sidomos ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë. Puna në sektorin e shëndetësisë është shumë e lidhur me sektorët e tjerë. P.sh. në QKUK kemi probleme me parking, të cilin nuk mund ta rregullojmë pa bashkëpunim me policinë. Sa u takon barnave, duhet të kemi bashkëpunim të mirë me doganat. E kemi një problem të kamotshëm me barnat me afat të kaluar. Për ta zgjidhur atë duhet të bashkëpunojmë me Ministrinë e Ambientit. Në punën tonë ka shumë pika doloroze. Të fillojmë me Projektligjin për sigurime shëndetësore, që do ta kemi në vjeshtë e vonë të këtij viti. Kjo çështje e ka historikun e gjatë. Kemi hasur në një rezistencë të madhe të FMN-së. Më parë një propozim parashikonte një fond prej 296 milionë eurosh. Pastaj e caktuam një grup pune me ekspertë të Universitetit Amerikan të Kosovës, që i kishin përgatitur disa propozime (skenarë). Pra, është duke u bërë punë e mirë. Projektligji është dorëzuar në Qeveri. Edhe propozimet e Bankës Botërore janë pranuar. Tash grupi i ekspertëve është duke i shqyrtuar mundësitë për zbatimin e tij dhe implikimet financiare. Në procedurë e sipër janë rreth 10 udhëzime administrative. Disa prej janë kundërtënesë. Pritet të bëhet në shtator miratimi i Draftstrategjisë 2010 - 2014. Po ashtu, është hartuar edhe Draftstrategjia e sistemit informativ të shëndetësisë, që pritet të miratohet në shtator. Jemi duke e hartuar strategjinë për shëndetin e fëmijëve dhe për shëndetin riprodhues. E kemi përfunduar Kornizën afatmesme të shpenzimeve. Me rishikimin e buxhetit, vërejtëm se kishim zvogëlim rreth 2 milionë euro. Janë përfunduar draftet për buxhetin e Ministrisë për vitin 2011. E kemi në zbatim e sipër edhe Planin e veprimit për partneritet evropian. Furnizimi me barna është pikë e dobët dhe ka parregullsi. Për pajisje mjekësore kemi buxhet prej 3.4 milionë eurosh. Përveç kësaj duhet të përqendrohemi edhe në mirëmbajtjen e tyre. Trajtimi i të sëmurëve jashtë vendit është problem i madh. Është shpenzuar i gjithë fondi i paraparë për këtë qëllim. Duhet të fillojmë t'i ndërrojmë këtë sistem dhe këtë koncept që ishin deri më tash. Vetëm në këtë gjashtëmuajt të vitit 2010 kemi pasur rreth 600 aplikues për shërim jashtë vendit. Janë miratuar 545, kurse janë refuzuar 22 prej tyre. Inspektorati i ka kontrolluar vazhdimisht institucionet shëndetësore dhe ka shqiptuar masa të ndryshme për to, ndonëse nuk kemi numër të mjaftueshëm të inspektorëve. E kemi emëruar u.d. shefin e AKPM-së. Procesi i ndarjes së specializimeve është zvarritur

shumë. Do të shpallim konkurse të reja për specializime. I kemi nënshkruar disa memorandume me shtete të ndryshme, si: Çeki, Austri, Itali dhe Maqedonia.

Përparësitë tona më të mëdha në këtë fazë janë: ligji për sigurime shëndetësore, konsolidimi dhe funksionalizimi më efikas i QKUK-së, avancimi i bashkëpunimit me partnerët tanë ndërkombëtarë, strategjia sektoriale 2010-2014, ofrimi i shërbimeve të reja, p.sh.: Onkologjia, Kardiokirurgjia, furnizimi me barna dhe freskimi i kuadrit me specializime jashtë Kosovës.

Zotohemi se jemi jetësisht të interesuar të bashkëpunojmë shumë me Komisionin për Shëndetësi. Ju siguroj se do të jemi shumë transparentë për çdo çështje që ju intereson.

Sadik Idriz - Gjatë kohës sa kam qenë ministër, kemi pasur buxhet shumë të vogël për shërim jashtë vendit, gjithsej 1 milion e 200 mijë euro për tre vjet të mandatit. Do të ishte mirë që për shumë çështje të njoftohemi drejtpërdrejt nga ju dhe jo nëpërmjet mediave, siç ka ndodhur për Klinikën e Kardiokirurgjisë private, që po ndërtohet në oborrin e QKU-së. Dua ta theksoj çështjen e bashkëpunimit ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë. Në Bullgari kemi parë se kishin zyrtarë në Ministri, që ishin të ngarkuar për bashkëpunim me Parlamentin. Edhe ne duam të keni një të tillë, në mënyrë që për secilin njoftim, që na intereson, të mos ju thërrasim. Kështu do ta funksionalizojmë më mirë bashkëpunimin ndërmjet Komisionit dhe Ministrisë.

Rita Hajzeraj - Shëndetësia është në gjendje shumë të rëndë për shkak është ndarë pak buxhet për këtë sektor. Shkak tjetër i kësaj gjendjeje të rëndë është edhe menaxhimi i keq në vazhdimësi. Më vjen mirë që ju po i pranoni problemet. A keni paraparë që së pari ta siguronit fondin, pastaj ta nxirrni ligjin për sigurime sociale, apo një herë keni menduar ta nxirrni ligjin, pastaj ta krijoni fondin? Sa u takon barnave, më herët kemi pasur buxhet 6 milionë, kurse tash i kemi 20 milionë euro. Listat e barnave esenciale nuk kanë ndryshuar fare. Deri ku keni arritur me decentralizimin e institucioneve shëndetësore, në mesin e të cilave hyn edhe QKUK-ja?

Gjynaze Sylja - Nuk është mirë që për drejtor të QKUK-së të emërohet personi që deklaroi se është anëtar i PDK-së, si menaxher i një institucioni, përcjell mesazh të keq për të tjerët. A është lista e barnave ajo që u duhet vërtet pacientëve, apo ndoshta po porositin barna që janë në depon e Mazgitit? Kujtoj se nuk po bëhet shumë për besueshmërinë e mjekut. Mungon njoftimi se çfarë rastesh trajtohen në institucionet tona. Kështu ndihmojmë që pacientët tanë të dalin për shërim jashtë vendit pa pasur nevojë. A keni njoftim sa do t'i kushtojë buxhetit tonë shkatërrimi i barnave në depon e Mazgitit? Duhet të ketë transparencë për kriteret e shërimit jashtë vendit, sepse kam shumë të dhëna se procesi i përzgjedhjes për shërim jashtë vendit është keqpërdorur jashtë kriterëve mjekësorë. Duke e pasur parasysh KASH-in, vihet në pikëpyetje zbatimi i ligjeve të përmendura që do të nxirren, si p.sh.: ligji për sigurime shëndetësore, ligji për shëndetësi, strategjitë e ndryshme etj. Pse inspektorët shëndetësorë paguhën më pak se ata të punës?

Teuta Hadri – Dua të diskutoj për këto çështje: gjendjen e shëndetësisë, furnizimin me barna - listën esenciale, auditimin e brendshëm të produkteve dhe të pajisjeve medicinale, çështjen e projekteve kapitale, përparësitë e shëndetësisë dhe ligjin për sigurime shëndetësore. Do të ishte mirë të bëhet një azhurim më i mirë i listës esenciale të barnave.

Ka pasur paqartësi se a është dhe si është shfrytëzuar fondi për projekte kapitale. Nuk ka shëndetësi pa fondin për sigurime shëndetësore. Do të duhej të cekej në raport sa i përket dorëzim-pranimi të detyrës, që të dihet se në çfarë gjendje e keni gjetur kur e keni marrë detyrën.

Nurishahe Hulaj - Ministri veproi mirë kur garantoi se punëtorëve shëndetësorë do t'u jepeshin 44 euro shtesë. Disa komuna nuk po ua japin këto mjete. A që këto të futen si pagë e rregullt? A keni kompetenca të plota për zbatimin e Ligjit për Inspektoratin Sanitar? A ka mundësi të bëhet decentralizimi i furnizimit me barna?

Qamile Morina – Ministri e vuri në pah adresimin e problemeve. Është mirë që e keni formuar grupin për sigurime shëndetësore. Çka do të bëni që sektori publik të mos jetë i diskriminuar në raport me sektorin privat? Kur rastet ndërlikohen në institucionet private, në institucionet publike i zgjidhim, madje pa pagesë. Duhet të gjendet një formë që edhe për ne, në institucionet publike shëndetësore, të ketë pagesë për këto raste. Duhet ta ngremë zërin më shumë që shëndetësia të bëhet vërtet përparësi e kësaj Qeverie, jo vetëm gojarisht. Probleme të mëdha mbesin Kardiokirurgjia dhe Onkologjia. Do të ishte më mirë të merreshin ekspertë nga jashtë, sesa të dërgojmë kuadro jashtë për aftësim. Kështu do t'i kursenim mjetet që shpenzohen për trajtim jashtë vendit. Këto janë çështje në të cilat duhet të punohet sa më parë. Këtu ka aq shumë probleme, sa që një hap sado i vogël do të ishte i mirëseardhur. Udhëzimi administrativ për shërim jashtë vendit, ende i pafuqizuar, që është për trajtimin e të sëmurëve jashtë institucioneve publike, mendoj se është diskriminues. Këtë e them, sepse ka raste, kur për shkak të mungesës së materialit, i cili mund të sigurohet nga Ministria, pacientët shkojnë dhe kryejnë shërbime në institucione private. Këto shërbime mund të kryheshin pa asnjë problem në institucione publike, vetëm po të sigurohej materiali nga Ministria. Institucionet publike i zgjidhin problemet e institucioneve private - rastet e rënda, kurse institucionet private nuk mund t'u konkurrojnë institucioneve publike. Po të zbatoheshin rekomandimet e miratuara në Kuvend, nuk do të kishim kaq shumë probleme me barnat. 6 milionë ndahen për citostatikë. Si është e mundur të ndahen kaq shuma të mëdha, kur nuk kemi institut onkologjik. Nuk mund të mbahen evidencat se kush po i shpërndan, kush i ka marrë barnat, si e ka marrë etj. Meqë nuk kemi evidencë për to ka mundësi të bëhen keqpërdorime me buxhetin për citostatikën. Nëse arrini ta lini një dokument detyrues për reformimin e sistemit shëndetësor, pa marrë parasysh mandatin, do të ishte çështje kapitale.

Flora Brovina – Shëndetësisë deri më tash i ka munguar një vizion, një politikë e mirëfilltë shëndetësore. Besoj në punën tuaj, që do ta bëni me ekipe, sepse individit e ka vështirë të kryejë punë të suksesshme. Dy janë çështjet më të rëndësishme: sanimi i gjendjes dhe preventiva. Nga përvoja ime e di se për shëndetësi të mirë duhet të kemi pasqyrë të qartë të terrenit. Nuk kemi shumë komponentë që na e mundësojnë ta kemi një pasqyrë të mirë. Në sistemin e njoftimit ka mangësi të shumta, që e pengojnë realizimin e projekteve që i përmendët. Ka shumë hapësirë për ndryshime në shumë sektorë, si në ligjin për shëndetësi. P.sh. në Onkologji, përkatësisht në preventivë, më lirë kushton një kontroll sistematik i grave, sesa citostatikët, që nevojiten për mjekim.

Vezira Emrush - Unë i njoh më pak sesa koleget e mia këto çështje, sepse nuk jam në këtë profesion. Megjithatë dua t'i them ministrit se duhet të ketë llogari të qartë të hyrjedaljeve të mjeteve që i ka ky sektor. Decentralizimi duhet të bëhet gjithsesi, sepse centralizimi vetëm e rrit mundësinë për korrupsion. Duhet të ketë fonde për sigurime shëndetësore dhe për sigurime sociale.

Është e vërtetë se në fillim nuk mund të kemi fond me shumë milionë. Mund të fillojmë me një shumë më të vogël. Nëse të gjithë të punësuarit, p.sh. 250 000, sa janë, i ndajnë nga 2 euro në muaj, në vit do ta kemi një fond prej 6 milionësh. Duhet ta dimë se të gjitha këto fonde duhet t'i kenë linjat e qarta të hyrjeve dhe të daljeve. Po ashtu këto fonde duhet të jenë të ndara, si p.sh.: për sigurime sociale, shëndetësore, të arsimit, të kulturës, etj. Propozoj të ketë çmimore, si në sektorin publik, edhe në atë privat, sepse në këtë mënyrë do të parandaloheshin keqpërdorimet që po ndodhin. Po ashtu me listën e barnave esenciale duhet të kemi shumë kujdes. Duhet të bëhet e qartë se cilat grupe sociale kanë të drejtë në listën esenciale, si p.sh.: pleqtë, fëmijët etj. Pra, duhet ta kemi një rregullore për shfrytëzimin e listës së barnave esenciale. Për 2 milionë banorë të Kosovës i kemi 14 mijë punëtorë shëndetësorë, ndërkaq vendet e tjera kanë më shumë. P. sh. Serbia i ka 22 mijë. Nga kjo del se kemi numër të madh të të punësuarish në këtë sektor. Për këtë duhet tjetër sistematizim dhe tjetër skemë organizative. Duhet të rritet aktiviteti i Inspektoratit, sepse aktiviteti i institucioneve shëndetësore duhet të jetë në pajtim të plotë me Ligjin për Shëndetësi. Nuk të lejohet të hapen institucione shëndetësore në objekte që nuk i plotësojnë kushtet themelore.

Sadik Idriz – Është punë e keqe dhe e papranueshme që licencimin në shëndetësi ta bëjnë komunat, sepse e dimë se çfarë mund të pasojë nga kjo. Prishtina duhet ta ketë spitalin e vet rajonal dhe QKUK-ja të mbetet qendër referente e nivelit tretësor.

Bujar Bukoshi - Diagnoza është mjaft e qartë. Kemi probleme dhe derivate të problemeve. Ju garantoj se do ta sigurojmë personin që do të mbajë kontaktet me Komisionin. Është e papranueshme të mos kemi fond për sigurime shëndetësore. Këtë duhet ta bëjmë gjithsesi. Lista esenciale duhet të shqyrtohet shumë seriozisht. Sa i përket u.d. të drejtorit të QKUK-së, udhëheqësit nuk duhet t'i shfaqin preferencat politike në ushtrimin e funksionit të tij. Imazhi i mjekut është degraduar shumë. Pa marrë parasysh vendosmërinë tonë, shpesh jemi të detyruar t'u nënshtrohemi disa procedurave burokratike, që na e ngatërrojnë punën. Shtesa prej 44 euro, sipas ministrit të Financave, do të jepet në rrogën e muajit korrik. Kemi bërë një prerje të parregullsive, si në Onkologji, po ashtu i kemi dërguar në EULEX dosjet për të cilat kemi dyshime. Duhet të gjenden mekanizma ta forcojmë sektorin publik dhe të mos ketë diferenca të mëdha ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.

Haxhi Kamberi - Lista e barnave esenciale është 18.5 milionë e jo 20 milionë. Në të përfshihen barnat, citostatikët, imunizimi dhe hemodializa. Auditimi nxjerr pah se në shpërndarjen e barnave ka përmirësim prej 13% si pasojë e menaxhimit të mirë. 85% e kërkesave për barna nga QKUK-ja janë realizuar. Sa i takon Mazgitit, Ministria e Ambientit duhet t'i shkatërrojë barnat me afat të kaluar. Sa i përket decentralizimit, QKUK-ja sivjet i ka 20 milionë euro për t'i menaxhuar dhe secili spital rajonal menaxhon

me mjete të veta. Përveç mjeteve që parashihen në KASH, kërkohen edhe 31 milionë euro për t'i realizuar projektet e parapara. Ekziston drafti final për SISH.

4. Rishqyrtimi i planit të punës të Komisionit

*Në mungesë kuorumi, pika 4 e rendit të ditës, **Rishqyrtimi i planit të punës të Komisionit**, u shty për mbledhjen e radhës.*

5. Të Ndryshme

Gjylnaze Syla - U shtrua këtu çështja e kompetencave që me Projektligjin për Prishtinën, i jepet komunës së Prishtinës. Aty është një dispozitë që do të bëjë zgjidhje diametralisht të kundërta, pra jo të unifikuara në Kosovë. Komisioni për Shëndetësi duhet t'i bëjë dy amendamente: që komuna nuk mund të bëjë licencimin dhe Prishtina ta ketë një spital rajonal.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50

E përqatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz